



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN**

**Nr.459-05/2012**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje**, me gjyqtarin **Gjimshit Galushi**, dhe procesmbajtësen **Nexhla Vebiqi** në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **Xhavit Uka** nga fsh. **Piranë KK Prizren**, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe neni 9 , të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të **Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, e në bazë të neni 195 të **LMK-së**, me datën **25.10.2013** merr këtë :

**A K T V E N D I M**

**I pandehuri Xhavit Faik Uka**, i lindur me **21.05.1962**, në fsh. **Piranë KK Prizren**, ku edhe jeton

**Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s**

**Sepse**, sipas kërkesës së Agjencionit, e si Zyrtare i lartë publik – deputetë në asamble komunale në Prizren, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë dhe prejardhjen e saj, pranë Agjensisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (**deri më 31.03.2012**), edhe pse ka qenë i obliguar,

- me kete veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të **Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, e për këtë, duke aplikuar nenin 9 të **LMK-së**.

**D E N O H E T**

**Me gjobë në lartësi prej 350 ( treqind e pesëdhjetë )Euro .**

I pandehuri obligohet që denimin e shqiptuar me gjobë, ta paguajë në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi . Poqese këtë nuk e bën në afatin e caktuar, atëherë gjoja e shqiptuar do të zavendsohet me burgim, duke llogaritur **20 euro për një ditë burgu**, kurse në afatin e njejtë në emër të shpenzimeve gjyqësore, do të paguajë shumën prej **5 (pesë) euro**, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër Korupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1874-/2012 të datës **24.05.2012** , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit lartëcekur , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës të pandehurit , i cili në deklaratën e tij ka theksuar se është e vërtet që deklarin e pasurisë e ka bërë pak me vonesë , për shkak të obligimeve dhe detyrave në institucione. Ka theksur edhe faktin se çdo vit, lajmërimin e pasurisë ka bër me kohë , përveq kësaj here , dhe ato për shkak të obligimeve të shumta . Formularin për deklarin e pasurisë e ka plotësuar , dhe me datën **24.08.2012** e ka dërguar formularin në Agjencion kundër korupsionit të Republikës së Kosovës , i cili edhe është pranuar me të njejtën datë.

Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimit të deklaratës së të pandehurit , si dhe vlerësimit të të gjitha provave së bashku dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se me datën **24.08.2012** i pandehuri me të vërtet kishte plotësuar , por edhe ka dërguar formularin mbi deklarin e pasurisë në Agjencinë kundër korupsionit , i cili ishte pranuar me të njejtën datë , edhe pse pas afatit për dorzim .

Duke pasur parasysh rethanat nga neni 7 të LMK-së , se i njejt ka patur sjelljet korekte , e poashtu faktin se çdo vit ishte përgjigjur në afatin e caktuar ligjor, Agjencionit kunder korupsionit , se nga afati ligjorë për deklarin e pasurisë kanë kaluar disa muaj , mirpo egziston fakti se i pandehuri në fjal edhe pse me vonesë , e ka përmbush obligimin e vet, gjykata është qëndrimin se në veprimet e të pandehurit egzistojnë elementet e veprës së kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë , e duke aplikuar nenin 9 të LMK-së , e ka zbutur denimin , duke patur parasysh sjelljen e tij korekte , se deklarin me vonesë ka bër nga obligimeve dhe detyrave të shumta ndaj institucioneve , me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që i njejt në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjorë .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit 109.2 të LMK-së .

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit .

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje**  
Nr.459-05/2012, datë: **25.10.2013**



Gjyqtari  
Gjimshir Galushi

**UDHËZIMI JURIDIK** : Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur , mund të ushtrojë ankesë , Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve , pas marrjes të të njejtit , përmes kësaj Gjykate .